

RREGULLORE

KONKURSI KOMBËTAR ME MATURANTËT:

SIPËRMARRËSIT E SË NESËRMES, EDICIONI 8 | JURISTËT E SË NESËRMES, EDICIONI 4

1. NJOFTIMI

Sot, më datë 1 Mars, Tirana Business University College (TBU) nisi procesin e regjistrimit të maturantëve për të dy konkurset e përvitshme kombëtare:

- ▣ **Sipërmarrësit e së Nesërmes, Edicioni 8**
- ▣ **Juristët e së Nesërmes, Edicioni 4**

Në të gjitha edicionet e viteve të kaluara konkurset janë organizuar në bashkëpunim me kompanitë dhe bankat më të mëdha të vendit, si dhe me vlerësimin, inkurajimin dhe mbështetjen e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR). Këtë vit konkurset po mbështeten jo vetëm nga partnerët tashmë tradicional por edhe nga partnerë të rinj.

Vit pas viti pjesëmarrja është rritur ndjeshëm falë promovimit dhe angazhimit të mësuesve, drejtuesve të gjimnazeve, DAR/ZA-ve, partnerëve të ndryshëm dhe ekipit organizativ të TBU. Në vitin e fundit në të dy konkurset u regjistruan rreth **650 nxënës**.

Për secilin konkurs do të ketë disa kategori çmimesh dhe fituesish. Fituesit do të përfitojnë mbështetje financiare për bursa studimi në TBU dhe çmime të veçanta nga mbështetësit e konkursit.

Inkurajojmë maturantët e të gjitha shkollave të mesme të përgjithshme ose profesionale të vendit, të apasionuar e me prirje në sipërmarrje apo në jurisprudencë të formojnë ekipe dhe të aplikojnë në njërin apo të dy konkurset.

2. REGJISTRIMI I EKIPEVE

Afati i fundit i regjistrimit është data 31 Mars 2018, ora 18.00.

Në të dy konkurset, si rregull, marrin pjesë ekipe me maturantë. Tek “Sipërmarrësit e së Nesërmes” ekipi formohet me 3-5 maturantë, ndërsa tek “Juristët e së Nesërmes” ekipi formohet me 2-3 maturantë. Nga një gjimnaz mund të formohet më shumë se një ekip. I njëjti ekip mund të konkurrojë në të dy konkurset. Ekipi mund të ndërtohet edhe me pjesëmarrjen e maturantëve nga shkolla të ndryshme. Emri i ekipit është i lirë të ideohet sipas preferencës. Në rast se maturantët nuk arrijnë të ndërtojnë ekip, inkurajohet pjesëmarrje edhe si individ.

Regjistrimi bëhet online duke plotësuar të dhënat në linkun: bit.ly/tbuedual.

Çdo komunikim tjetër pas regjistrimit do të kryhet me:

tel: +355 42 60 443, cel: +355 68 360 0725; +355 69 98 119 25 dhe/ose e-mail: info@tbu.edu.al.

3. RRETH TBU

TBU është institucion i arsimit të lartë me fokus në 2 drejtime bazë:

▣ **Administrim Biznesi:** i) Menaxhim; ii) Financë & Kontabilitet; iii) Marketing; iv) Teknologji & Informacion

▣ **Drejtësi:** Juridik i Përgjithshëm

Studimet ofrohen në nivelin Bachelor dhe në nivelin Master Profesional ose Master Shkencor.

TBU ndryshe nga shkollat e tjera vendos theksin në formimin praktik të gërshtuar dhe të harmonizuar me atë teorik që studentët zhvillojnë përgjatë studimeve të tyre, pa krijuar mangësi apo boshllëqe në asnjërën fushë formimi.

Aftësimi në praktikë i studentëve fillon që në vitin e parë Bachelor dhe vijon me rritje në vitet e mëtejshme.

Aftësimi në praktikë është një mundësi reale për t'u pozicionuar e punësuar sa më shpejt në tregun e punës. Përmes praktikës profesionale TBU synon e mundëson punësimin e studentëve që para mbarimit të studimeve.

Praktikat profesionale kryhen në mbi 50 kompani dhe/ose zyra juridike, nga më të mëdhatë dhe prestigjioze të vendit, nën drejtimin, mbikqyrjen dhe vlerësimin e stafeve me eksperiencë të tyre si edhe të stafit të TBU. Përgjatë etapave të praktikës studenti provon disa procese të ndryshme menaxheriale apo juridike përmes të cilave ai merr një formim më të plotë si dhe zbulon atë drejtim ku ai mund të jetë më premtues, më konkurrues e më i suksesshëm si profesionist apo sipërmarrës.

Nga tetori 2014, Grupi Balfin (www.balfin.al) është aksioner në TBU. Balfin është grupi më i madh i biznesit në Shqipëri, me mbi 3500 punonjës, me aktivitet të zgjeruar edhe jashtë Shqipërisë, që përmbledh kompani të mirënjohura si Neptun, TEG, QTU, Digitalb, Spar Albania, Jumbo, Fashion Group, AlbChrome, Fin-al, ManeTCI, etj. Grupi Balfin ndihmon në pozicionimin e praktikantëve të TBU si dhe identifikon profesionistë të ardhshëm që i bashkohen kompanive të grupit.

Si rezultat i këtij modeli, çdo student që ka përfunduar studimet Master në TBU është i punësuar në pozicione pune sipas profilit të studimeve; pjesa dërrmuese e studentëve që aktualisht po vazhdojnë studimet Master në TBU janë punësuar përmes praktikave të organizuara nga TBU ndërsa të tjerët kanë shanse të mira për t'u punësuar së shpejti para përfundimit të programit; nga studentët aktualë të vitit të tretë Bachelor, më shumë se gjysma e tyre janë punësuar që këtë vit përmes praktikave të organizuara nga TBU dhe të tjerët vijojnë praktikat disamujore drejt një punësimi, me shumë gjasa, i sigurt së afërmi. Për më tepër shihni online leaflet me të dhënat e punësimit, gjeneruar në Janar 2018: <http://bit.ly/tbu-punesimi>.

Ndaj, me bindje e krenari themi se në TBU: **Nuk merrni vetëm diplomë por nisni karrierën!**

TBU ofron bursa studimi (të plota dhe të pjesshme) duke vlerësuar performancën e studentëve apo duke ju gjendur pranë në vështirësi ekonomike dhe/ose sociale.

Bursat ofrohen për dy kategori: i) për maturantët/studentët me rezultate të larta dhe ii) për maturantët/studentët në nevojë. Për të njëjtat rezultate në mësim apo praktikë, TBU mbështet me prioritet punësimin e studentëve më në nevojë.

Për më shumë informacion, vizitoni www.tbu.edu.al ose faqen tonë në **facebook, instagram, linkedin**, etj.

4. ZHVILLIMI I KONKURSEVE

I. Sipërmarrësit e së Nesërmes, Edicioni 8

Tematika: Ekipet e maturantëve aplikojnë me **ide biznesi** të shtjelluara në formate plan-biznesi, të cilat më pas i prezantojnë para një jurie ekspertësh dhe biznesmenësh.

Konkursi përfshikon dy faza:

Faza 1 (me shkrim):

Çdo ekip krijon idenë e tij të biznesit dhe e paraqet në një format standart të plan-biznesit (jo më shumë se 10 faqe A4), sipas formatit bashkëlidhur në **Aneksin Nr. 1** të këtij njoftimi.

Afati: plani i biznesit dorëzohet me e-mail brenda datës **7 Prill 2018, ora 18.00.**

Faza 2 (prezantim në skenë):

Çdo ekip që dorëzon plan-biznesin ftohet të prezantojë idenë e biznesit, si dhe elementet kyç të planit të biznesit. Prezantimi do të jetë në format powerpoint dhe i pajisur me efekte vizuale para jurisë së përbërë nga ekspertë dhe biznesmenë. Prezantimi kryhet për jo më shumë se 20 minuta dhe në prezantim kontribuon çdo anëtar i ekipit.

Afati: Prezantimet do të zhvillohen në ambjentet e TBU, duke filluar nga data tentativë **10 Prill 2018, ora 10.00-17.00**. Harku kohor i prezantimeve do të përcaktohet në varësi të numrit të ekipeve pjesëmarrëse. Numri i ekipeve që do të prezantojnë në një ditë do të jetë jo më tepër se 10. Ekipet do të njoftohen për ditën që do të bëjnë prezantimin.

Kriteret e vlerësimit që do të aplikohen nga juria do të fokusohen në:

- ☞ ideja e biznesit dhe shtjellimi i idesë të ilustruar në plan-biznes;
- ☞ prezantimi i idesë dhe zotërimi i idesë.

II. Juristët e së Nesërmes, Edicioni 4

Tematika: Ekipet e maturantëve ftohen të ndërmarrin role për trajtimin e çështjeve ligjore (casus), si “palë e paditur” kundrejt “palës paditëse” në formën e “gjqytimitimitues”. Ekipet të regjistruara do t'u caktohen e dërgohen nga TBU casus-et gjyqësore menjëherë pas regjistrimit.

Konkursi përfshikon dy faza:

Faza 1 (me shkrim): Çdo ekip për casus-in e dhënë përgatit edhe padinë edhe mbrojtjen, secila jo më shumë se 2 faqe dhe sipas udhëzimeve të TBU që do të jepen bashkë me casus-in gjyqësor.

Afati: Çdo ekip dërgon me e-mail në info@tbu.edu.al padinë edhe mbrojtjen brenda datës **23 Prill 2018, ora 18.00.**

Faza 2 (prezantim ne seancën e gjyqit imitues): Ekipet me të njëjtin casus gjyqësor e që kanë dërguar padinë dhe mbrojtjen ftohen të përballen në çift, njëri në rolin e palës paditëse dhe tjetri në rolin e palës së paditur. Rolet do të caktohen paraprakisht pak para fillimit të gjyqit imitues. Pala paditëse parashtron argumentat e saj dhe pala e paditur parashtron argumentat e saj në një përballje në kohe reale për rreth 30 minuta përballë jurisë në rolin e trupës gjyqësore dhe e përbërë nga juristë me përvojë.

Afati: Prezantimet do të zhvillohen në ambjentet e TBU, duke filluar nga data tentativë **24 Prill 2018, ora 10.00-17.00**. Harku kohor i zhvillimit të gjyqeve imituese do të përcaktohet në varësi të numrit të ekipeve pjesëmarrëse. Çiftet e skuadrave do të lajmërohen për ditën kur do të zhvillojnë gjyqin imitues për casus-in e tyre.

Kriteret e vlerësimit që do të aplikohen nga juria do të fokusohen në:

- 👉 formën e argumentimit dhe racionalizimit mbi çështjen;
- 👉 paraqitjen e argumentave dhe aftësisë për t'u përballur në seanca live.

5. ÇMIMET DHE CEREMONIA E SHPALLJES SË FITUESVE

Si rregull, TBU jep çmime fituese për secilin konkurs bazuar në performancën individuale dhe në ekip, të përkthyer në mbështetje financiare për bursa studimi dhe çmime speciale nga partnerët e konkursit.

Në edicionin e kaluar, nga TBU, për fituesit e konkursit “Sipërmarrësit e së Nesërmes” u ofruan 12 kategori të çmimeve bazuar në performancën individuale dhe 9 kategori të çmimeve bazuar në performancën si ekip, ndërsa për fituesit e konkursit “Juristët e së Nesërmes” u ofruan 6 kategori të çmimeve bazuar në performancën individuale dhe 5 kategori të çmimeve bazuar në performancën si ekip. Gjithashtu, për konkursin “Sipërmarrësit e së Nesërmes” u ofruan 2 kategori të çmimeve speciale nga kompanitë partnere. Në total u akorduan 34 kategori të çmimeve.

Fituesve të çmimeve speciale iu akordua mbështetje teknike e financiare nga partnerët kryesorë si dhe bursë studimi 100% për të trea vitet e studimit bachelor, ndërsa fituesve të çmimeve bazuar në performancën individuale dhe në ekip iu akordua bursë studimi 40% për një vit akademik bachelor.

TBU pajis mësuesit shoqërues dhe shkollat me certifikatë vlerësimi dhe mirënjohje për kontributin e tyre në përgatitjen e ekipeve të maturantëve pjesëmarrës sipas konkurseve përkatëse.

Ceremonia e dhënies së çmimeve do të organizohet në Tiranë, në një datë që do të njoftohet në një moment të dytë. Ceremonia do të organizohet në prani të personaliteteve shtetërore, universitare, biznesit, medias, diplomacisë, etj. Në ceremoni janë të ftuar të marrin pjesë të gjitha ekipet, mësuesit shoqërues, prindër, miq e shokë të maturantëve. Vendi i ceremonisë do të njoftohet në një moment tjetër.

6. SHPENZIMET E UDHËTIMIT

TBU mbulon shpenzimet e transportit (kundrejt biletës shoqëruar me kupon tatimor ose faturë) të ekipeve dhe mësuesve shoqërues që nuk janë nga qyteti i Tiranës si për ditën kur vijnë në TBU ashtu edhe për ditën e ceremonisë së çmimeve. Në këto aktivitete do të ofrohen ushqim, ujë mineral, pije freskuese.

ANEKSI 1

FORMATI I PLANIT TË BIZNESIT

Plani i biznesit shërben për të ilustruar idenë e biznesit në një dokument “word”, maksimumi 11 faqe sipas strukturës së dhënë më poshtë:

Cover (Titulli [ideja e biznesit]; Emri i ekipit; Emri i Anëtarëve, Shkolla, Qyteti)

Faqe 1: Përmbledhje Ekzekutive (përshkrim sa më i saktë dhe i përmbledhur i idesë së biznesit – ku konsiston ideja e biznesit? Çfarë funksioni kryen? Argumentoni zgjidhjet që do të ofroni për problemet e mundshme të klientëve të synuar., etj. A siguron ky biznes të ardhura/fitim?)

Faqe 2: Historiku dhe Ekipi (përshkruani se si lindi ideja, si u formua ekipi drejtues, si dhe rolin e secilit anëtar; argumentoni pse jeni kandidatë të përshtatshëm për t’a ndërmarrë këtë nismë biznesi)

Faqe 3: Objektivat (ndërtoni objektivat që synoni të arrisni. Objektivat duhet të jenë specifike, të formuluar qartë, të matshme, si dhe të kufizuara në kohë duket përcaktuar afatet për realizimin e tyre)

Faqe 4: Produkti/shërbimi (përshkruani produktet/shërbimet që do të ofroni dhe karakteristikat e tyre. Ndaluni vecanërisht në cilësitë e produkteve/shërbimeve që ju mundësojnë avantazh konkurrues.

Faqe 5: Studimi i Tregut (përshkrim mbi identifikimin e tregut - cilët janë klientët e synuar? Përshkruani klientët (individë dhe/ose biznese) bazuar në cilësitë e tyre dhe nevojat/kërkesat/interesin për produktin/shërbimin tuaj, indentifikoni dhe përshkruani konkurrentët kryesorë)

Faqe 6: Analiza SWOT (indentifikoni pikat e forta dhe pikat e dobëta (mjedisi i brendshëm) si dhe shancet e kërcënimet (mjedisi i jashtëm) të idesë së biznesit. Ndërtoni strategjitë e biznesit, duke u mbështetur në pikat e forta, shfrytëzuar shancet, minimizuar dobësitë dhe ekspozuar me kujdes ndaj kërcënimeve.

Faqe 7: Strategjitë e Marketingut dhe Shitjeve (ndërtoni strategjitë që do të ndërmerrni për të promovuar biznesin sipas kanaleve të ndryshme të komunikimit (web, katalog, media, etj) e që përshtaten me llojin e aktivitetit dhe buxhetin e parashikuar, ndërtoni strategjitë e shitjes që do të ndërmerrni për zgjerimin e tregut/rritjen e shitjeve, etj.)

Faqe 8: Kostot e nisjes (nevojat për financim: tabela me të dhëna mbi shpenzimet/investimet deri në momentin e fillimit të procesit të shitjes të produkteve/shërbimeve.

Faqe 9: Sigurimi i fondeve (si do të gjenerohen apo sigurohen të ardhurat për të garantuar mbulimin e kostove për shitjet e para, prodhimin e parë, psh. 100 sasitë e para?)

Faqe 10: Pasqyrë / Tabelë Financiare (kostot e parashikuara + detyrime (taksa etj) + kosto marketingu + kosto shpërndarje e shitje vs. të ardhura nga shitjet dhe fitimi neto)

Faqe 11: Përmbyllje (përmbyllje e planit të biznesit me fokus diskutimin e së ardhmes të idesë së biznesit.)

Ndarja në faqe është në shërbim të një prezantimi të strukturuar, por jo domosdoshmërisht në paracaktim sasior. Psh, përmbledhja ekzekutive mund të jetë vetëm 2 paragrafe.